



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 26 -2008
Prishtinë, më 28 tetor 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Selvije Halimi, Kolë Berisha, Armend Zemaj, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj dhe Džezair Murati.

Munguan: Branisllav Grbiq dhe Ibrahim Makolli.

Të pranishëm: Reshit Gashi – NDI, Lumnije Murati – ZPRK, Megan Kassiakoff – OSBE, Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti KDI-BIRN, Fitore Zeneli – KDI dhe Lejla Selimi – OSBE.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 7 tetorit;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit;
4. Shqyrtimi i raportit për Projektligjin për presidentin e Republikës së Kosovës;
5. Shqyrtimi i Projektrezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë prej vitit 1945 deri në vitin 1999;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 7 tetorit

Kryetari i pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Kryetari duke diskutuar për Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit shtoi se këtë projektligj po e shqyrtojmë për të tretën herë në mbledhje të Komisionit. Shprehu bindjen se në mbledhjen e sotme do të shqyrtohet në tërësi. Shtoi se me angazhimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit kemi arritur deri te neni 32.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit vazhduan me shqyrtimin e Projektligjit nen për nen derisa përfundoi shqyrtimi i tij.

Amendamentet e propozuara nga anëtarët e Komisionit u votuan njëzëri.

4. Shqyrtimi i raportit për Projektligjin për presidentin e Republikës së Kosovës

Kryetari lidhur me shqyrtimin e raportit për Projektligjin për presidentin e Republikës së Kosovës fjalën ia dha raportuesit z. Bajram Kosumi, që raportoi për të. Z. Kosumi i paraqiti para anëtarëve të Komisionit vërejtjet dhe komentet e veta për të cilat tha se do t'i kemi me shkrim në mbledhjen e ardhshme të Komisionit.

Kryetari e falënderoi raportuesin për punën dhe angazhimin e tij.

5. Shqyrtimi i Projektrezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë prej vitit 1945 deri në vitin 1999

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës kryetari diskutoi për rolin dhe për rëndësinë e rezolutës me të cilën do të dënohen krimet e sistemit komunist. Për të ai e propozoi një draftrezolutë për anëtarët e Komisionit.

6. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës u diskutua ku ka ngecur puna për të drejtën sendore dhe se duhet të ndryshohet edhe nënkomisioni për të drejtën sendore. Tha se tash e tutje Ramadan Gashi do të jetë në vend të Riza Smakës dhe Armend Zemaj në vend të Nerxhivane Dautit dhe takimi i radhës do të mbahet të martën e ardhshme.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit diskutuan edhe për Projektligjin për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Ky komision vërejti lëshime brenda Projektligjit. Komisioni njëzëri kërkoi nga Qeveria që ky projektligj të ripunohet dhe në parim të mos lexohet fare.

E hartoi:
Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni